



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 21.9.2026

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR POZICIONET
E SHPALLURA NGA AZHBR**

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 10, datë 15.1.2026, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin mbi rezultatet e verifikimit për pozicionin e shpallur si më poshtë vijon :

I. DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PROTOKOLLIT DHE ARKIVËS

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-2.

• **Kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit janë:**

1. Xhuliana Kambo.
2. Amel Leka.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”;
- Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

A. Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **24.9.2026, ora 11:00**, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 56, Tiranë.

B. Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datë **24.9.2026, ora 12:00** dhe në vazhdim, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 56, Tiranë. Kandidatët do të paraqiten në intervistë sipas rendit alfabetik.

Të gjithë kandidatët për pozicionet e mësipërme, do të marrin informacion vetëm në faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al, për fazat e mëtejshme të procedurave të konkurrimit.

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL